

VENDIM
Nr. 684, datë 16.8.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES,
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK ME OBJEKT
“MIRËMBAJTJA E SISTEMIT TË MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të mbikëqyrjes elektronike”, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha